



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:166561  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05739997

Ac.nr.3272/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve D.P, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor prindi, B.P, B.P ,S.P, N.P, B.P dhe J.P, e të cilët i përfaqëson me autorizim avokatia F.C-M, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D” sh.a., të cilën e përfaqëson i autorizuari V.R, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve dhe të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.285/16 e datës 03.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 23.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN si të pathemelta ankesa e paditësve D.P, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor prindi B.P, B.P, S.P, N.P, B.P dhe J.P, të cilët i përfaqëson me autorizim avokatia F.C-M dhe ankesa e paditura Kompania e Sigurimeve “D” sh.a., dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë C.nr.285/16 e datës 03.03.2021.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin ankimor C.nr.285/16 e datës 03.03.2021, ka vendosur si vijon:

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit 1. D.P, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “D” sh.a., Rr. “Xhevdet Doda” pn., që paditësit 1. D.P, në emër të dëmit jo material dhe material të pësuar në aksidentin e datës 04.04.2016, t’ia kompensoi dhe atë:

1. Paditësit D.P;

Dëmin jo material:

- Në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 3,800.00 €
- Në emër të frikës së pësuar, shumën prej 3,200.00 €

- Në emër të zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 6,000.00 €
- Në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 2,000.00 €

Përtej shumës së aprovuar për dëmin jo material shuma prej 21,000.00 €, refuzohet si e pa bazuar.

Dëmin material:

- Në emër të ndihmës dhe përkujdesit të huaj, shumën prej 560.00 €
- Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 140.00 €
- Në emër të rehabilitimit fizioterapeutik, shuma prej 150.00 €
- Në emër të shpenzimeve të mjekimit, shuma prej 3,408.36 €

Përtej shumës së aprovuar kërkesa në emër të dëmit material, në shumë prej 2,553.69 €, refuzohet si e pa bazuar.

III. REFUZOHEN kërkesat e paditësve 2. B.P, 3. S.P, 4. N.P, 5. B.P dhe i mituri 6. J.P, në emër të dhimbjeve shpirtërore për përjetimet e tyre për shkak të lëndimeve trupore dhe të përhershme të paditësit D.P, secilit shuma prej nga 4,000.00 €, apo shuma e përgjithshme prej 20,000.00€, si të pa bazuara.

IV. Gjithsej shumën e aprovuar për paditësin D.P për të gjitha kategoritë e dëmit jo material dhe material që është shuma prej 19,258.36 €, të cilën detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes se këtij aktgjykimi dt.03.03.2021, deri në pagesën përfundimtare, po ashtu t'i paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,400.00 Euro, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuari i paditësve, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit për shpenzimet e procedurës, me propozim si në ankesë.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarës së tyre, pranë Gjykatës së shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "D" sh.a., për kompensim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të

lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se deri te aksidenti ka ardhur me fajin ekskluziv të drejtuesit të automjetit i cili ka qenë i siguar te e paditura, po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se paditësi D.P, i është nënshtruar shërbimeve mjekësore shëndetësore pranë institucioneve përkatëse dhe nga ekspertiza mjekësore e punuar nga ekspertet e mjekësorë Dr.S.D Ortoped-traumatolog, Dr.F.Q neurokirurg, Dr.N.S-Oftamolog, dhe Dr. V.B, është vërtetuar se paditësi D.P ka pësuar lëndime të renda trupor e që është manifestuar me dhimbje fizike, frik dhe format tjera të dëmit, të përshkuara si në arsyetimin e aktgjykimit. Më tej, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash ka theksuar se duke u bazuar në provat e administruara, mendimit të ekspertëve dhe sqarimeve të dhëna nga eksperti Dr. S.D në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësit D.P iu aprovuan shumat për kompensimin e dëmit jo material si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë: në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike shumën prej 3,800.00 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3,200.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor (në shkallë 14.50%) shumën prej 6,000.00€, si dhe në emër të shëmtimit trupor (shkallë e ulët) shumën prej 2,000.00€, kurse ju refuzua shumat përtej shumës së gjykuar si tejet e lartë dhe jo në harmoni me lëndimet e paditësit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës së përjetuar, si dhe pasojat e mbetura. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136, 140, 159, 169, 179, 183, 184 dhe 382 të LMD-së si dhe neneve 449, 450, 452 par.1 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të pathemelta qëndrojnë pretendimet ankimor të ndërgjyqësve për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ankuese, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadsisë se deri te aksidenti i ndodhur me datën 04/04/2016 ka ardhur si rezultat i lëshimeve të drejtuesit të automjetit A i cili ka qenë i siguar te e paditura, të cilin fakt e paditura e pohon në përgjigje në padi si dhe gjatë seancave gjyqësore dhe i ofron shumën e kompensimit për paditësin në lartës prej 13,500 euro, po ashtu si pasoj e këtij aksidenti e paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të renda trupore të cilat lëndim janë manifestuar me dhembje fizik dhe frikë si dhe ka pësuar dëme tjera material ashtu siç kanë konstatuar edhe ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional, dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se me

nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë. Në këtë rast e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ka kundërshtuar pjesërisht lartësinë e kërkesëpadisë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia, edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të lartcekura e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesat e aprovuar në shumën sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit si dhe shkallën e të mirës nga e cila është privuar dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarit-këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t'i riparojnë në një masë nevojat e tyre materiale, po ashtu Gjykata e Apelit në tërësi i akcepton edhe arsyet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me caktimin e lartësisë së kompensimit të dëmit, ngase shumat e gjykuara janë në harmoni me praktiken gjyqësore të krijuara deri me tani si dhe me Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë se shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material Gj.A.nr.41/2023 e dt.27/02/2023, prandaj gjykata e shkallës së parë drejt i ka aplikuar dispozitat materiale të paraparë me nenin 136, 159, 179 dhe nenit 183 të LMD-së. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur pjesërisht si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit po ashtu me kujdes të shtuar i ka analizuar pretendimet ankimore të autorizuarës së paditësve për pjesën refuzuese të kërkesëpadisë lidhur me paditësit tjerë, dhe të njëjtat i vlerësoj si të pa bazuara, sepse gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse se paditësve tjerë-anëtareve të ngushtë të familjes nuk ju takon e drejta në kompensimin e dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditetit të paditësit D.P, sepse edhe praktika gjyqësore e po ashtu edhe Udhëzimi i Gjykatës Supreme të Kosovës e ka konsideruar se invaliditeti tejet i rëndë, konsiderohet nëse i lënduari ka zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë mbi 50%, e që në rastin konkret me ekspertizën mjekësore është vërtetuar se paditësi D.P ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë prej 14.50%.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:166561  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05739997

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
Ac.nr.3272/21, me datë 23.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku